



Njoftim për Shkollën Verore “Politikanet e Reja”

Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin dëshiron t’ju njoftojë se ka filluar procedurat e pranimit të aplikimeve për Shkollën Verore dhjetëditore **“Politikanet e Reja”** për periudhën 1- 10 korrik 2008. Shkolla Verore organizohet në kuadër të projektit “Rritja e Rolit të Grave në Drejtim” i cili po zbatohet nga Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin dhe Forumi i Pavarur i Gruas Shqiptare në partneritet me Womankind Worldwide, me mbështetjen e Departamentit për Zhvillimin Ndërkombëtar të Mbretërisë së Bashkuar (DFID).

Kjo shkollë synon të transmetojë tek pjesëmarrëset ato elementë dijesh dhe shprehish praktike të cilat do t’i ndihmojnë për aftësimin për analiza politike konkrete, për të ndërtuar strategji të veprimit politik dhe elektoral, për komunikim dhe elementë të vendimmarrjes politike si në jetën e partisë politike ashtu edhe në organet e administratës publike .

Pjesëmarrja dhe kriteret e pranimit:

Pjesëmarrëset në shkollën verore do të jenë gra dhe vajza të interesuara për të bërë karrierë profesionale në fushën e politikës, të jetës publike apo në administratën publike. Kriteret e pranimit janë si më poshtë :

1. Kandidatja duhet të ketë shfaqur interes për jetën publike, politike, për mirëfunksionimin e pushteteve apo të ketë pasur një veprimtari të dëshmuar në kuadrin e funksionimit të aktorëve të shoqërisë civile (OJF, ndërmarrje biznesi, qendra studimore – këshillimore, media, administratë publike, sistemi i arsimit, etj.)
2. Të ketë arsim të lartë të çdo profili.
3. Të jetë e hapur ndaj opinionëve të ndryshme politike, të pranojë me tolerancë shprehjen e mendimeve dhe qendrimeve të kundërta politike si edhe të ketë etikën e debatit.
4. Kandidatja preferohet të jetë në një pozicion aktiv publik.
5. Të shprehë qartë motivimin e pjesëmarrjes në Programin “Shkolla Shqiptare e Politikës” dhe interesat për zhvillim karriere.
6. Të jetë i rekomanduar nga dy persona të cilët i njohin aftësitë akademike, profesionale, kërkimore dhe personale të kandidatit.
7. Moshë e kandidatit duhet të jetë deri në 40 vjeç.
8. Të paguajë një shumë simbolike prej 2000 lekësh.

Dokumentacioni i pranimit:

1. Formular i plotësuar i kërkesës.
2. Fotokopje e letër – njoftimit ose e pasaportës, ose një certifikatë e zakonshme lindjeje
3. Një CV e të interesuarës
4. Kopje e diplomës së shkollës së lartë
5. Një letër interesi për të marrë pjesë në shkollën verore
6. Dy rekomandime, secila e mbyllur në zarf dhe e firmosur nga rekomanduesi

Personat e interesuar janë të lutur të paraqiten në zyrat e Qendrës Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin për të tërhequr formularin e kërkesës apo t'i shkarkojë ato nga faqja e internetit www.acpd-al.org

Afati përfundimtar për dorëzimin e aplikimeve është data 15 Qershor 2008 ora 17:00.

Dorëzimi i aplikimeve duhet të bëhet pranë Zyrës së Qendrës Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin:

Bulevardi "Gjergj Fishta", Kompleksi "Tirana 2000", Kulla 4, Tirane.

Për çdo informacion telefononi në numrat: 04 253839; 04 251 475; ose dërgoni email tek: info@acpd-al.org